



PRISHTINA

Raporti dhe procesi i punës, bazuar në premtimet 4 vjeçare të Kryetarit, Z. Përparim Rama.

Periudha
(07 dhjetor 2021 - 07 dhjetor 2022)

Kategorizimi i premtimeve të Kryetarit dhe statusi i tyre në bazë të ngjyrave.

30

Përbushur

24

Gjysëm
i përbushur

3

Pjesërisht
e përbushur

110

Filluar

38

Nuk ka
filluar

Gjithsej: 205 Premtime

KRYEQYTETI	TË DHËNAT	VLERËSIMI
Premtimet		
<p>Krijimi i Zyrës së Arkitektit të Qytetit</p>	<p>Janë identifikuar nevojat e shërbimeve inxhinierike/investive. Janë përpiluar termat e referencës konform nevojave të identifikuar. Aktiviteti për shërbimin e Arkitektit të qytetit është zhvilluar me procedurë të kufizuar që parasheh dy faza. Faza e parë, e cila është e parakualifikimit ka përfunduar ku janë kualifikuar 5 operator ekonomik. Ndërsa tash jemi në fazën e dytë ku pritet të bëhet dorëzimi i ofrimit të çmimit për kryerjen e shërbimeve (ofertat financiare)</p>	<p>Gjysëm i përmbushur.</p>
<p>Rritja e numrit të inspektorëve komunal përmes riorganizimit të drejtorive.</p>	<p>Procesi i rekrutimit të inspektorëve të rinj është në fazën finale.</p> <p>Si fazë e parë janë shpallur gjithsej:</p> <p>8 (tetë) inspektorë të shërbimeve publike (rendit komunal)</p> <p>4 (katër) inspektorë të ndërtimit</p> <p>3 (tre) zyrtarë te Sektori i pyjeve; të cilët janë në</p> <p>fazën e testimit - intervistimit të kandidatëve sipas procedurave nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike. Përveç kësaj, është përgatitur dhe ka marrë pëlqimin e kryetarit edhe lista prej 55 zyrtarëve shtesë e cila është dërguar në Drejtorinë e Personelit. Përmes kësaj rritjeje është paraparë edhe krijimi i Sektoreve të veçanta – të reja.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Drejtoria e Inspektionit do të krijoj platformë online për komunikim me qytetarë, për t'i paraqitur vërejtjet dhe kërkesat e tyre.</p>	<p>Derisa kërkesat janë gati të diagnostifikuara për një sistem që lejon përcjelljen e statusit të një ankese/kërkese me numër, jemi në proces të gjetjes së fondeve për mbulimin e shpenzimeve me partnerë të rinj që kanë fokus përmirësimin e komunikimit dhe transparencës me qytetarë.</p> <p>Në ndërkohë ka filluar trajtimi i ankesave nëpërmjet rrjeteve sociale deri në krijimin e një platforme të mirëfilltë digjitale për pranimin e ankesave/kërkesave nga qytetarët. Kjo metodë e komunikimit me qytetarët nëpërmjet rrjeteve sociale ka mundësuar që të arrijmë të trajtojmë rreth 50 kërkesa në javë duke mos i përfshirë ato që pranojmë nëpërmjet emailit zyrtar dhe thirrjeve telefonike.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Themelimi i zyrës së analizave, e cila do të përdorë të dhëna për vendim-marrje.</p>	<p>Kemi themeluar zyrën e analizave në përbërje të tri drejtorive (urbanizëm, prona dhe planifikim) dhe përfaqësues të kabinetit të kryetarit, në kuadër të së cilës është komisioni për shqyrtimin dhe analizimin e aplikimeve për kushte ndërtimore. Ky komision bën të mundur që procesi i marrjes së vendimeve në fazën e kushteve ndërtimore të jetë më transparent si dhe më cilësorë.</p>	<p>I përbushur</p>
<p>Formimi i zyrës së veçantë për analizë, hartim dhe menaxhim të projekteve; nga aprovim i buxhetit deri në fillimin e vitit fiskal</p>	<p>Kemi krijuar zyre (Njësinë për Implementimin e Projekteve Madhore), e cila merret me hartimin dhe menaxhimin e projekteve të rëndësishme për transformimin e Kryeqytetit. Kemi angazhuar 5 menaxherë projektësh, të profileve të ndryshme inxhinierike të cilët do e përbëjnë njësinë për menaxhimin e projekteve në Komunën e Prishtinës. Për me tëpër, kemi hapur thirrjen për të angazhuar edhe 10 ekspertë shtesë, nga të cilët 3 janë përzgjedhur.</p>	<p>I përbushur</p>
<p>Krijimi i Inspektoriatit të Gastronomisë.</p>	<p>Në kuadër të rritjes së numrit të inspektorëve (planifikimi shtesë procesit të filluar aktualisht), janë bërë analiza në bazë të së cilave është planifikuar edhe krijimi i Inspektoratit të Gastronomisë me rreth 10 (dhjetë) inspektorë për fazën e dytë.</p> <p>Ashtu siç është potencuar më sipër, përveç listës së mësipërme të inspektorëve të cilët do të pranohen, është përpiluar edhe një plan për shtimin e mëtejshëm të numrit të inspektorëve (55 pozita). Përmes këtij procesi është planifikuar që të themelohet edhe një sektor i veçantë, Sektori i Gastronomisë i cili në fazën e parë do t'i ketë 7 inspektorë, duke përfshirë edhe udheheqësin e Sektorit dhe 2 zyrtarë ndihmës.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Nxitja e grave dhe vajzave për të qenë pjesë e konsultimeve publike, në mënyrë që të sigurojmë një pjesëmarrje të barabartë gjinore në këto takime.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, Komuna e Prishtinës ka organizuar disa takime me qytëtar në disa lagje të qytetit si “Ulpiana”, “Dodona” “Kolovica” “Shkabaj” “Arbëria” dhe në lagjen “Qendra”. Konsultimet publike janë zhvilluar për dy fusha: e para për t’u njohur me problemet dhe kërkesat e qytetarëve dhe e dyta lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore. Thirrjet për takime kanë qenë publike, përmes web faqes, rrjeteve sociale dhe janë vendosur njoftime me shkrim në afërsi të shkollave në zonat përkatëse. Prezenca e qytetarëve në gjitha fotografitë e paraqitura ka qenë e kënaqshme, duke përfshirë edhe gratë. Takimi në “Kolovicë” është mbajtur vetëm me gratë.</p>	<p>I përmbushur.</p>
<p>Eliminimi i konkurseve të Komunës së Prishtinës me përmbajtje diskriminuese gjinore</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor, Komuna ka shpallur tri konkurse (në fushën e arsimit për angazhim në lëndët zgjedhore, dy konkurse për edukator/e në çerdhet e qytetit) të shpallura nga komuna e Prishtinës. Në të tri rastet, Komuna ka publikuar konkurse të cilat u bëjnë ftësë pjesëtarëve të gjinive të ndryshme që të aplikojnë, duke shmangur gjithë diskriminuese në konkurse. E njëjta praktikë është ndjekur edhe një një thirrje publike për subvencionim të aktiviteteve kulturore.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Themelimi i një Task Force për të fuqizuar ndërlidhshmërinë e arsimit në Prishtinë me nevojat e tregut të punës</p>	<p>Është themeluar Task Forca e brendshme në bashkëpunim me LuxDev për ndërlidhjen e proceseve arsimore me nevojat e tregut të punës. Për më tepër është themeluar UPCO Cluster, iniciativa e parë triple-helix në Kosovë në mes të Universitetit të Kosovës, Odës Ekonomike të Kosovës dhe Komunës së Prishtinës. Me përcaktimin e bordit, qendra ka filluar punën dhe aktivitetet për qëllim kryesor kanë zvogëlimin e hapësirës në mes të edukimit dhe tregut të punës.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Riorganizimi i rrjetit shkollor, në mënyrë që mos të kemi shkolla me hapësira të mëdha e numër të vogël të nxënësve, e njëkohësisht të kemi shkolla me hapësirë shumë të vogël e numër të madh të nxënësve.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>

<p>Themelimi i drejtimit të “Kodimit (IT)” në Shkollën e Mesme Elektronike “Gjin Gazulli”</p>	<p>Drejtimi për Teknologji Informativë dhe të komunikimit në Gjin Gazull është zgjeruar dhe përfshin drejtime të reja, që brenda kanë edhe kodimin. Drejtimet e reja janë: Teknik i Sistemeve të Informatikës, Zhvillues i Aplikacionit dhe Teknik i Informatikës. Stafi profesional i shkollës është trajnuar që të fillojë zbatimin e këtyre drejtimeve. Gjithashtu me kërkesën tonë në kuadër të bashkëpunimit me LuxDevin drejtimi i Kodimit-Programimit pritet të jetë njëri ndër drejtimet kryesore të shkollës së re profesionale të TIK-ut në Prishtinë.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Themelimi i drejtimit “Guidë Turistike” në Shkollën e Mesme “7 Shtatori”.</p>	<p>Në SHML “7 Shtatori” për herë të parë në vitin shkollor 2022/2023 priten drejtimet e reja si Asistent për Turizëm, Asistent për Hotelieri dhe Asistent për Tregti. Pra, pika si Asistent për Turizëm parasheh edhe Guidën Turistike.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Mbështetje shkollave të mesme profesionale, të cilat kanë për synim aftësimin e nxënësve për prodhim.</p>	<p>DKA ka filluar me aktivitete të prokurimit publik për pajisjen e shkollave me kabinete dhe mjete përkatëse që kanë për synim aftësimin e nxënësve në shkollat profesionale dhe në prodhim. Të gjitha shkollat profesionale po furnizohen me kabinete specifike për realizimin e punës praktike të drejtimeve të ndryshme. Gjithashtu, janë bërë investime në rritjen e kapaciteteve të Bibliotekave dhe pajisjeve të punës. (p.sh kemi blerë instrumente muzikore për shkollën “Prenk Jakova” dhe Traktor për shkollën “Abdyl Frashëri”)</p> <p>Kemi blerë 235 pc dhe laptopë për të gjitha shkollat profesionale dhe kemi kompletuar të gjitha kabinetet e IT-së në të gjitha shkollat profesionale.</p> <p>Për herë të parë kemi bërë sigurimin ndaj aksidenteve për nxënësit e shkollave profesionale ku do të përfshihen rreth 2200 nxënës gjatë punës praktike.</p> <p>Kemi bërë furnizim me pajisje kabinetike dhe mjete të punës: Prenk Jakova, instrumente të ndryshme muzikore</p> <p>Ali Sokoli – kabineti i infermerisë dhe material shpenzues për katër profile “Abdyl Frashëri” Traktorë, serrë të rë dhe kos</p> <p>28 Nëntori plotter për planifikim arkitektonik.</p>	<p>I përmbushur</p>

<p>Do të themelohen ndërmarrje sociale në shkolla, fitimet e të cilave do të bartën në fondin vetanak të shkollave.</p>	<p>Shkollat kanë filluar organizimin e klubeve të cilat kanë synim ndërlidhjen e mësimit, praktikës dhe prodhimit në shkollat profesionale. Kjo platformë e funksionimit po i paraprinë themelimit të Ndërmarrjeve Sociale në Shkolla, kjo sa i përket përgjegjësive të komunës së Prishtinës. Pjesa e themelimit dhe çertifikimit të Ndërmarrjeve Sociale parashihet me Ligjin për Ndërmarrjet Sociale dhe nuk mund të bëhet derisa Ministria e Financave dhe Transfereve nuk themelon Departamentin për Ndërmarrjeve Sociale i cili licenson këto ndërmarrje.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i një shkolle në lagjen “Sofalia”</p>	<p>Është paraqitur njoftimi për dhënie të kontratës në platformën e e-prokurimit. Është bërë inicializimi i kontratës nga Kryetari dhe operatori ekonomik i rekomanduar dhe pas miratimit nga KPPP (Komiteti për Partneritet Publiko-Privat) do të bëhet nënshkrimi i kontratës. Është nënshkruar kontrata me PPP për ndërtimin e shkollës në lagjen Sofalia.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i një shkolle në lagjen “Kodrina”</p>	<p>Është paraqitur njoftimi për dhënie të kontratës në platformën e e-prokurimit. Është bërë inicializimi i kontratës nga Kryetari dhe operatori ekonomik i rekomanduar dhe pas miratimit nga KPPP (Komiteti për Partneritet Publiko-Privat) do të bëhet nënshkrimi i kontratës. Është nënshkruar kontrata me PPP për ndërtimin e shkollës në lagjen Kodrina.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i një shkolle në lagjen “Qëndresa”.</p>	<p>Është paraqitur njoftimi për dhënie të kontratës në platformën e e-prokurimit. Është bërë inicializimi i kontratës nga Kryetari dhe operatori ekonomik i rekomanduar dhe pas miratimit nga KPPP (Komiteti për Partneritet Publiko-Privat) do të bëhet nënshkrimi i kontratës. Është nënshkruar kontrata me PPP për ndërtimin e shkollës në lagjen Qëndresa.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i një shkolle në lagjen “Kroi i Njelmët”</p>	<p>Me IFC kemi filluar fazën e dytë të projektit dhe financimit, me të cilin projekt do të ndërtohen edhe 4 Shkolla. Modeli i projektit është PPP, sikurse edhe ndërtimi i 3 shkollave aktuale.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Ndërtimi i një shkolle në lagjen “Kalabria”</p>	<p>Projekti është finalizuar dhe është buxhetuar për 2022-2023.</p> <p>Është siguruar leja e ndërtimit për projektin në shkollën në lagjen Kalabria.</p> <p>Projekti për ndërtim është finalizuar dhe së shpejti fillon procesi i tenderimit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i një shkolle në lagjen “Kodra e Trimave”</p>	<p>Afati i aplikimit dhe verësimit të ofertave në prokurim për Master Planin e Kodrës së Trimave (Rigjenerimit) ka përfunduar. Jemi në pritje të përfudimit të afatit të ankesave. Kjo do të hapë rrugë për të krijuar hapësirë/lokacion për shkollën. Më pas do të bëhet edhe projekti detaj për ndërtim të shkollës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i një shkollë në zonën “Prishtina e Re”, afër Pallatit të Drejtësisë.</p>	<p>Është ndarë lokacioni nga Kuvendi Komunal dhe projekti i shkollës është duke u finalizuar, financimi i të cilit do të bëhet nga Ministria e Arsimit. Projekti ideor është përzgjedhur dhe tani jemi në fazën e hartimit të projektit kryesor.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i shkollës “Liceu Artistik”, e cila përfshin: drejtimin e muzikës dhe baletit, artit dhe dramës dhe gazetarinë.</p>	<p>E kemi proceduar në buxhetin e vitit 2023; Është analizuar dhe përzgjedhur lokacioni. Janë përpiluar termat e referencës dhe është proceduar për prokurim për përzgjedhjen e hartuesit të projektit kryesor me të gjitha fazat. Faza e parë e prokurimit ka përfunduar dhe janë parakualifikuar 5 studio projektuese. Ndërsa tash jemi në fazën e dytë ku pritet të bëhet dorëzimi i ofrimit të çmimit për kryerjen e shërbimeve (ofertat financiare)</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i Gjymnazit “Ahmet Gashi” në lokacionin aktual.</p>	<p>Projekti për renovimin e tërësisë së SHML “Ahmet Gashi” është miratuar nga Komanda Evropiane e Ushtrisë Amerikane, programi për ndihmë humanitare. Projekti do të implementohet nga Komanda e Marinës për Sisteme Inxhinierike. Renovimi do të fillojë në 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Secili objekt shkollor do të ketë sallë të edukatës fizike dhe terrene sportive adekuate të pajisura.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 është nënshkruar një kontratë përmes procedurave të prokurimit për rregullimin e terrenëve sportive në shkolla. Vlera e kontratës është 52,847 euro. Për këtë qëllim janë buxhetuar 150,000 euro për vitin 2022. Deri në fund të muajit qershor punët në rregullimin e këtyre terrenëve kanë nisur në shkollën “Eqrem Çabej” dhe në shkollën “Nazmi Gafurri”.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Për çdo vit do të ndërtohen nga dy çerdhe në lagjet/zonat në të cilat ka mungesë të tyre.</p>	<p>Kuvendi Komunal në mbledhjen e datës 29.06.2022 ka ndarë tre (3) lokacionet për ndërtim të çerdheve: në lagjen Mati I, në lagjen Kolovica e Vjetër dhe në lagjen Kolovica e Re. Këto lokacione do të dërgohen për financim në Ministri të Arsimit dhe Komision Evropian.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Evidentimi i nxënësve që kanë braktisur shkollën dhe ata do t'i nënshtrohen një trajtimi/programi adekuat për kthimin e tyre në shkollë.</p>	<p>Evidentimi i braktisjes së shkollës nga nxënësit është bërë nga shkollat dhe të dhënat dërgohen mbi baza mujore në DKA e Prishtinës. Përveç kësaj, fillimi i ndonjë programi ose trajnimit për ri-sistemimin e tyre nuk ka pasur.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndarja e bursave për nxënësit me arritje të larta, për nxënës me gjendje të rëndë sociale, dhe për nxënës me pengesa në zhvillim.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022, Kryeqyteti ka dhënë 120 bursa për studentë dhe në përshkrimin e kritereve për përfituesit, është saktësuar, se përveç kritereve të përgjithshme (banor i Prishtinës në dhjetë vitet e fundit dhe studentë i regjistruar në tri vitet e fundit) ceken edhe kriteret e veçanta, nota mesatare, studentët me vërtetim që tërheqin ndihmë sociale dhe studentë me nëvoja të veçanta. Për dy kategoritë e fundit janë vendosur 20 pikë me automatizëm, pastaj janë vlerësuar nota mesatare dhe profili i studimeve.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Subvencionimi i pagesave për fëmijë që regjistrohen në institucionet parashkollore, me bazë në komunitet dhe ato private.</p>	<p>Subvencionimi i pagesave për fëmijë në IP është subvencionuar vetëm tek IP me bazë në komunitet, varësisht prej pagës së prindërve të fëmijëve.</p> <p>Tëk IP-të private ky proces nuk ka filluar.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Themelimi i bibliotekave dhe këndevetë leximit në të gjitha shkollat ku ato mungojnë.</p>	<p>Është bërë furnizimi me libra shkollor në 13 shkolla të Prishtinës për të filluar orën e leximit. Përfitues do të jene 8000 nxënës të shkollave fillore dhe janë trajnuar 300 mësime dhënë klasore. Gjithashtu janë tenderuar ndërtimi i tetë bibliotekave të reja.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Përkrahja dhe përfshirja e vajzave dhe grave në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë.</p>	<p>Për herë të parë në Prishtinë në maj 2022 është organizuar iniciativa "Vajzat në TIK". Aty janë organizuar disa aktivitete ku vajzat kanë shfaqur talentin e programimit dhe përdorimit të teknologjisë. Festivali është mbuluar financiarisht nga komuna, ndërsa kanë marrë pjesë gjitha kompanitë e programimit, dizajnit dhe IT-së. Përmes udhëheqësisë me përvojë në këtë drejtim, Komuna bën pjesë aktivisht edhe në grupin WomenInSTEM Kosova dhe DigiWomen Cluster, përveç pjesëmarrjes proaktive në secilin organizim, tryezë për bashkëpunim në këtë fushë.</p>	<p>I përmbushur</p>

<p>Ofrimi i bursave për vajzat nga zonat rurale, të cilat zgjedhin të vijojnë mësimet në një nga shkollat e mesme profesionale në qytet.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Zonimi i Bujqësisë. Disa zona do të karakterizohen si zona për prodhimin e perimeve. Disa zona tjera si zona për mbjelljen dhe gjenerimin e pemëve. Në zona të tjera do të fuqizohet zhvillimi i blegtorisë dhe bletarisë. Përkrahja e ndërtimit të stallave.</p>	<p>Në kuadër të hartimit të PZHK-së (drafti final), janë analizuar kategoritë e përmendura duke marrë marrë parasysh cilësinë e tokës dhe përshtatshmërinë për kulturat adekuate dhe është përcaktuar zonimi i tyre.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Furnizim me pajisje për mjelje, ftohje dhe dhoma të qumështit.</p>	<p>Kemi hapur thirrjen për aplikim për bujqit dhe kemi hapur tenderin për blerje të pajisjeve. Janë përzgjedhur përfituesit dhe është zgjedhur kompania e cila do ta bëjë furnizimin. I gjithë procesi pritet të përfundoj në Dhjetor të vitit 2022.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Përkrahje me ndihma veterinare për të siguruar mbrojtjen e shëndetit dhe parandalimin e sëmundjeve të kafshëve shtëpiake.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 Komuna e Prishtinës ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me shoqatën "Fondacioni për Drejtat e Kafshëve" "Qëllimi kësaj marrëveshje bashkëpunimi përfshin, por nuk kufizohet në monitorimin e projekteve që janë në zhvillim e sipër apo projektëve që mund të fillojnë në të ardhmen, të cilat zhvillohen apo udhëhiqen nga komuna, që kanë të bëjnë me mirëqenien e kafshëve shoqëruese (shtëpiake)</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ofrimi i mbështetjes për bujqit në kultivimin e bimëve mjekuese dhe aromatike, deri në 100 fermerë do të përkrahen për të zhvilluar këtë aktivitet.</p>	<p>Fermere gra të cilat kultivojnë bimë aromatike mjekuese janë mbështetur përmes projektit SIREDA, projekt ky i mbështetur nga ADA në Kosovë dhe implementuar nga Caritas që Komuna bashkëfinancon aktivitete bujqësore. Po ashtu, Komuna ka bërë thirrje për subvencionimin me pagesa direkte për të gjithë prodhuesit e bimëve mjekuese aromatike.</p>	<p>i përmbushur</p>
<p>Investimi në ndërtimin/krijimin e pikave grumbulluese për pemët e imëta dhe krijimin e frigoriferëve statik për ruajtjen e prodhimeve bujqësore.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Organizimi i trajnimeve të veçanta për bujqit dhe fermerët.</p>	<p>Komuna e Prishtinës ka organizuar një sesion trajnues/informues lidhur me mënyrat e reja të aplikimit në subvencionet dhe grantet e MBPZHR.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Punësimi i 500 të rinjëve për çdo verë nga shkollat profesionale të qytetit dhe studentë në punë praktike me pagesë.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë angazhuar 11 praktikantë pagesë dhe janë shpërndarë në drejtori të ndryshme.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Krijimi i tregut modern për tregtarët dhe për prodhuesit vendorë.</p>	<p>Kuvendi Komunal i Prishtines ka autorizuar Kryetarin Rama per te negociuar me Qeverine e Kosoves, ne menyre qe Ndermarrja Shoqerore "Tregu" te transferohet ne Ndermarrje Lokale "Tregu". Kjo i jep mundesi kryeqytetit te menaxhoj me hapesirat e tregjeve, dhe te filloj modernizimin e tregjeve ne territorin e Prishtines.</p> <p>Poashtu është inicuar modernizimi i tregut mobil dhe tashmë e ardhshme tregu Blej Shqip në datat 27-29 nëntor edhe me shitje online.</p> <p>Kemi pasur pesë takime zyrtare me përfaqësuesit e tregut të gjelbër në Prishtinë me të cilët kanë diskutuar lidhur me modalitetet e ndërtimit të tregut të ri dhe lidhur me problemet që kjo kategori ka gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Përmirësimi, zgjerimin dhe avancimin e sistemit të ujitjes për tokat bujqësore.</p>	<p>Komuna e Prishtinës në këtë vit ka subvencionuar të gjitha ujitjet e tokave që fermeret kanë bërë përmes sistemit të Iber Lepencit</p>	<p>Gjysëm i përbushur</p>
<p>Rrregullimi i shtretërve të lumenjëve, për të siguruar mbrojtje nga ndotjet dhe vërshimet.</p>	<p>Projekti për pastrimin e lumenjëve dhe kanalizimit atmosferik është tenderuar janë dorëzuar ofertat ndërsa tani është në fazën e vlerësimit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Analiza të rregullta të ujit, tokës, dhe analiza të tjera për fermerët që prodhojnë për tregun e eksportit.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Mbështetja e bizneseve të vogla dhe ndërmarrjeve të sapo krijuara (start-ups).</p>	<p>Kemi krijuar tregun e bizneseve të vogla, përmes shtëpizave në sheshin Edit Durham, ku 6 prej tyre janë biznese të grave start up (biznese me punë artizanale autoktone). Në Gusht është shpallur lista e përfituesëve: https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_perfitueseve_tregu_i_bizneseve.pdf</p>	<p>I përbushur</p>
<p>Rritja e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës (përmes konkurseve, stimulimeve dhe subvencioneve)</p>	<p>Në secilën thirrje për aplikim në subvencione apo grante dhe tregun mobil nga Drejtoria e Bujqësisë, përparësi në përzgjedhje si fitues kanë pasur gratë fermere, po ashtu përmes Projektit SIREN, ku përfitues janë më shumë se 50 gra fermere vetëm në vitin 2022.</p>	<p>I përbushur</p>
<p>Përcaktimi i zonave strategjike për zhvillim të gastronomisë, siç janë "Kafet e Vogla", "Rruga B", "Rruga ABC", "Kafet e Rakisë", këto zona do të bëhen të veçanta.</p>	<p>Ka filluar organizimi i grupit punues në këtë drejtim. Festalet e mbajtura në ditët e mbylljes së qarkullimit të këtyre rrugëve janë me qëllim të testimit të ideve. Deri në fund të vitit do të nisat implementimi, krahas Rregullores për Gastronomi.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Rishikimi i tarifave të tatimit në pronë, sipas zonave.</p>	<p>Gjatë rishikimit kemi kuptuar që Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministri të Financave bën caktimin e tarifave për tatimin në pronë në nivel nacional (ne si Kryeqytet kemi aplikuar tarifen me të ultë të mundshme nga Rregullorja dhe Ligjimi i Tatimit në Pronë)</p>	<p>I filluar</p>
<p>Buxheti i përgjegjshëm gjinor.</p>	<p>Përvec pjesëmarrjes aktive në punëtori të jashtme, Komuna ka nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit me organizatën UN Women në të cilën ndër pikat kryesore të bashkëpunimit është buxheti i përgjegjshëm gjinor. Si rezultat i kësaj marrëveshje, ka filluar auditimi gjinor në aspektin financiar në tri (3) Drejtori të përzgjedhura: Planifikim Strategjik, Shërbime Publike dhe Kulturë.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Mbështetje kompanive vendore duke përdorur produktet dhe shërbimet e tyre.</p>	<p>Kryeqyteti ka mbështetur organizimin e festivalit të gastronomisë si dhe ka vazhduar me lëvizjen e tregut të produkteve bujqësore/vendore nëpër pjesë të ndryshme të qytetit. Të dy këto organizime përveç që janë mbështetur nga komuna, janë promovuar në menyrë të veçantë në opinion. Shtesë kësaj, është organizuar festivali Blej Shqip i cili është mbajtur më 27-29 nëntor në Sheshin Skënderbe.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Mbulimi i një pjesë të kostos së trajnimit për punëtorët e rinj në fushen e IT-së.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ofrimi i asistencës për bizneset e grave, përmes hapjes së një zyre për këshillëdhënie për bizneset e grave.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ofrimi i përkrahjes financiare për biznese duke kushtëzuar punësimin e grave.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Lidhja e sheshit “Nënë Tereza” me zonën e qytetit të vjetër të Prishtinës.</p>	<p>Kemi filluar analizën dhe studimin e fizibilitetit dhe projekti do të trajtohet me kontratën e projektit të Zyrës së Arkitektit e cila është në fazën përfundimtare.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i “Sheshit Historik të Prishtinës” dhe lidhja e tij deri të zona e Rrethit të Flamurit.</p>	<p>Komuna ka themeluar një grup punues i përberë nga ekspertë, zyrtarë dhe përfaqësues të lagjeve, që si grup ka për qëllim të ofrojë modalitetet që duhet të ndiqen nga komuna në ndërtimin dhe shfrytëzimin e zonës historike të Prishtinës. Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 në këtë zonë është shenjësuar objekti i parë i shkollës shqipe në Prishtinë dhe i njëjti pritët t'i nënshtrohet konzervimit. Ky projekt do të trajtohet me Arkitektin e qytetit.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Ndërlidhja e zonës ‘Qendra’ me lagjet përreth, përmes platformave të gjelbra dhe shtigjeve të transportit alternativ.</p>	<p>Është skicuar projekti për 3 ura të përkohëshme të lidhjes së lagjes Qendër me Arberinë dhe Aktashin dhe lidhja e Pallatit të Rinisë me Grand Hotelin të cilat janë tenderuar dhe janë në procedurë të vlerësimit pasi që janë buxhetuar me rialokim të mjeteve. Ndërsa pjesa kryesore do të trajtohet me Arkitektin e qytetit e cila është në fazën e fundit të tenderimit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i nënkalimit për levizjen e veturave nga rrethi i Veternikut deri tek Stacioni i Autobusëve.</p>	<p>Kemi filluar analizën, mirëpo pjesa kryesore e fizibilitetit dhe projektit do të trajtohet me kontratën e projektit të zyrës së Arkitektit e cila është në fazën përfundimtare të tenderimit. Është në vlerësim kontrata e projektit ideor.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Mbi nënkalim nga Veterniku deri tek Stacioni i Autobusëve, ndërtohet hapësira urbane që ndërlidh dy lagjet e mëdha të qytetit, “Dardaninë” dhe “Kalabrinë”.</p>	<p>Kemi filluar procesin e tenderimit për studimin e fizibilitetit, procedura e të cilës është në fazën e vlerësimit të kontratës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i Unazës së Mesme të Prishtinës, nga rruga e Veternikut - deri tek Zona Industriale- e deri tek Qendra e Panairëve.</p>	<p>Kemi përfunduar dizajnin final në bashkëpunim me BERZH, Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukture dhe pas dakordimit final në mes të palëve pritet të del në diskutim publik për 120 ditë.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Përfundimi i Unazës së Qendrës, duke vazhduar rrugën tek hekurudha nga Rrethi i “Arbërisë” deri tek Rrethi i Madh Fushë Kosovë-Prishtinë</p>	<p>Kane filluar punimet në Nëntor për ndërtimin e rrugës.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Realizimi i projektit rruga "A".</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 komuna ka përgaditur dosjen e tenderit për të shpallur ofertën tenderuese për ndërtimin e segmentit të parë të rrugës "A".</p> <p>Nga projekti i hartuar del që rruga "A" është me 3 korsi në një drejtim dhe 3 korsi në drejtimin tjetër, stazen e çiklizmit në dy anët, trotuar në gjerësi 1.5 metër dhe shtegu i gjelbërt.</p> <p>Vlera e fazës së parë është llogaritur në 9.5 milionë euro. Faza e parë përfshin relacionin nga Vetërniku, deri te pjesa e poshtme e rrugës "B" si dhe nga Vetërniku në Emshir. Projekti ka gjithësej tri faza dhe parashihet të zgjasë 5 vite deri në përfundim. Është bërë elaborati i shpronësimit për fazën e parë të trasesë së rrugës A. Janë kontaktuar shumica e pronarëve për gjetjen e modaliteteve për shpronësim. Për fazën e dytë dhe të tretë jemi në proces për përcjelle në tenderim në Shtator për projektimin detal të rrugës "A". Drejtorja e Kadastrit ka ofruar të dhënat/shënimet kadastrale ekzistuese Drejtorisë së Pronës, Investimeve Kapitale si dhe ekspertizën profesionale në rastet e nevojshme. Gjithashtu për fazën e parë (1.5 km) jemi në proces të vlerësimit të kontratave.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Vazhdimi i rrugës "B" duke ndërtuar kolektorin atmosferik, kanalizimin fekal, rrjetin e ujësjellësit, infrastrukturën elektrike dhe telekomunikuese.</p>	<p>Është kontratë aktive e vitit paraprak e cila për shkak ngritjes së çmimeve është pezulluar dhe pritet të kemi suvencionim të kontratave për të vazhduar si projekt. Është bërë elaborati i shpronësimit. Janë kontaktuar shumica e pronarëve për gjetjen e modalitetetve për shpronësim.</p> <p>Është dhënë leja nga drejtorja e urbanizmit për rrënimin e objekteve që mundëson fillimin e punimeve.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i rrugës Vetërnik-Hajvali, duke u lidhur me rajonin e Gollakut dhe Anamoravës.</p>	<p>Ndërtimi i kësaj rruge është pjesë përbërëse e projektit të unazës së mesme. Projekt-dizajni është në fazën përfundimtare. Pritet të del në diskutim publik në fillim të vitit 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i Rrugës me katër korsi 'Bajram Bahtiri' në Llukar.</p>	<p>Në kuadër të rialokimit të mjeteve (bartjes) i kemi ndarë një pjesë të mjeteve për fillimin e këtij projekti. Është përcjellur në tenderim dhe është në fazën e vlerësimit të kontratave në prokurim.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Nga Fusha e Pajtimit, në drejtim të fshatrave Makovc, Llukar dhe Grashticë. Do të trajtohet lumi në të gjithë gjatësinë e tij, duke përfshirë kanalizimin, ujësjellësin, shëtitoretja përbri dhe kolektori atmosferik.</p>	<p>Është tenderuar një pjesë e rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit prej Makovcit deri në Llukar i cili është në fazën finale të vlerësimit ndërsa pjesa për Grashticë do të tenderohet deri në vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i rrugës nga Gjumnazi “Sami Frashëri” në drejtim të Tregut të Gjelbër. Ky projekt do të përfshijë kolektorin atmosferik, kanalizimin fekal, rrjetin e ujësjellësit, infrastrukturën elektrike dhe telekomunikuese.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Investime në ndarjen e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në qytet.</p>	<p>Në çdo projekt të tenderuar deri më tani është planifikuar ndarja e rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik. Ky investim do të jetë pjesë e procesit të punës gjatë tërë kohës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Zgjidhja e problemit të kanalizimit në të gjitha fshatrat e Prishtinës, gjatë dy viteve të para të mandatit.</p>	<p>Në kuadër të bartjes së mjeteve, dhe në buxhetin e vitit 2023, i kemi paraparë (buxhetuar) një pjesë të mjeteve për trajtimin e kanalizimit nëpër fshatrat e Komunës së Prishtinës. Gjatë janar-dhjetor kemi investuar në Besi, Bardhosh, Mramor, Suteske, Hajvali dhe Rimanishtë.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i rrugës mbi kolektorin atmosferik në lagjen “Kalabria”</p>	<p>Është pjesë përbërëse e projektit të rrugës A.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe atmosferik në Hajvali (Prishtina e Re), më saktësisht për zonën që fillon nga Pallati i Drejtësisë dhe e përfshin pjesën dërrmuese të Hajvalisë.</p>	<p>E kemi në procedurë të tenderimit i cili është në OSHP</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i mbikalimit tek Stacioni i Trenit, i cili lidhet me Pallatin e Rinisë.</p>	<p>Komuna ka përgatitur dokumentacionin teknik, kadastral, pronësor dhe urbanistik dhe për hartimin e projektit planifikohet hapja e një konkursi ndërkombëtar. Drejtoria e Kadastrit ka ofruar të gjitha shënimet kadastrale ekzistuese dhe ekspertizën e stafit të sektorit të gjeodezisë në ekipin që ka punuar në këtë çështje.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i rrugës Barilevë- Bardhosh - Prishtinë</p>	<p>Kjo rrugë është pjesë e buxhetit të vitit 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i 430 vend-parkime të reja në lagjen “Ulpiana”, në formë të dis-nivelit, duke ruajtur gjelbërimin e lartë tij.</p>	<p>Ndërmarrja publike komunale “Prishtina Parking” ka shenjëzuar zonat për parking të veturave në lagjen “Ulpiana”. Këto zona menaxhohen nga kjo kompani dhe numri i tyre tëjkalon shifrën prej 430 vend parkingjeve. Por investime në krijimin e dis-nivelit nuk ka pasur. Drejtoria e Kadastrit i ka siguruar të dhënat kadastrale pronësore të kërkuara zyrtarisht nga NPL “Prishtina Parking”, duke qenë asistuese-ndihmuese në këtë proces.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>

Përfundimi i parkingut nëntokësor tek AKP-ja, duke e zhvendosur Tregun e Gjëlber mbi sipërfaqen e parkingut.	Kemi marrë në pronësi pronën e AKP-se.	I filluar
Ndërtimi i parkingut për automjetpërmes Unazës së Brendshme të Zonës Qendër që përfshin rrugën “Agim Ramadani”, Bulevardin “Bill Clinton”, rruga “Tirana” dhe rruga e UÇK-së.	Projekt i trajtuar me Prishtina Parking.	I filluar
Ndërtimi i parkingut nëntokësor te Posta Qendrore, duke e ruajtur gjelbërimin lart	Ky projekt do të trajtohet me kontratën e Arkitetit të Qytetit.	Nuk ka filluar
Ndërtimi i parkingut nëntokësor në lagjen “Dardania”.	Ky projekt do të trajtohet me kontratën e Arkitetit të Qytetit.	Nuk ka filluar
Ndërtimi i mbikalimit tek shkallët e “Arbërisë”.	Është buxhetuar për vitin 2023.	I filluar
Ndërtimi i nënkalimit që lidhë “Rrethin e Flamurit” me “Rrethin e QKUK-së”, i cili do të ketë të integruar edhe një parking nëntokësor tek hyrja e qytetit në zonën në mes tre rathëve.	Ky projekt do të trajtohet me kontratën e Arkitetit të Qytetit.	Nuk ka filluar
Ndërtimi i nënkalimit për vetura në rrugën “Agim Ramadani”, i cili do të mundëson lidhjen organike të zonës së vjetër të qytetit me qendrën	Kemi ndarë buxhetin në vitin 2023 për fillimin e projektit. Jemi duke punuar në shpime gjeomekanike arkeologjike, sepse është zonë historike andaj pasi ti marrim analizat mendojme që vitin 2024 të punohet ky projekt. Për finalizimin e projektit detal do të trajtohet me kontratën e arkitektit të qytetit.	I filluar
Nënkalim për vetura në pjesën nga Katedralja në drejtim të Fakultetit Filologjik.	Do të trajtohet me kontratën e Arkitetit të Qytetit	Nuk ka filluar
Brenda dy vitëve përfundon rrjeti i kanalizimit për fshatrat Rimanishtë, Bardhosh, Besi, Bërnice, Grashticë, Busi, Slivovë, Kukavicë, Dragoc, Novosellë, Siqevë, Radashevc, Sharban, Koliq, Ballaban, Nishevc, Prapashticë, Dabishevc, Hajkobilë, Gillogovicë dhe Keqekollë.	Në vitin 2022 kemi ndërhyrë në shumë pjesë të fshatrave të Prishtinës (Mramor, Llukar, Bardhosh, Prugovc dhe Makovc kemi trajtuar një pjesë të rrjetit të kanalizimit). Poashtu edhe me bartje të mjeteve kemi nda mjetet për Kanalizimin në Fshatin Rimanishtë, ndërsa mjetet për vitin 2023 i kemi ndarë për pjesën tjetër të fshatrave.	Gjysëm i përbushur
Investime në rrjetin e ujësjellësit, në një pjesë të madhe të fshatrave të Gollakut, duke krijuar rezervuar qendror për fshatrat e Gollakut në Mramor dhe Rimanishtë.	Do të trajtohet me kontratën e Arkitetit të Qytetit	Nuk ka filluar

<p>Ndërtimi i dy punkteve të reja të zjarrfikësve.</p>	<p>E kemi diskutuar mundësinë me zjarrfikësit e Prishtinës. Megjithatë, AME është përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve të zjarrfikësve. Marrë parasysh se ka dykuptimësi në çështje e kompetencave, na është thënë nga niveli qendror, se shpejt do ta rregullojnë këtë çështje, duke i bartur të gjitha kompetencat në nivelin qendror. Nëse kjo nuk ndodhë deri në fillim të vitit të ardhshëm, me zjarrfikësit do të diskutojmë opsionet tjera.</p>	<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Themelimi i njërive vullnetare të zjarrfikësve.</p>	<p>E kemi diskutuar me zjarrfikësit e Prishtinës. Megjithatë, edhe këtu AME është përgjegjëse për ngritjen e kapacitetëve të zjarrfikësve, përfshirë edhe ata vullnetarë. Siç edhe e theksuam më lartë, marrë parasysh se ka dykuptimësi në çështje e kompetencave, na është thënë nga niveli qendror, se shpejt do ta rregullojnë këtë çështje, duke i bartur të gjitha kompetencat në nivelin qendror. Nëse kjo nuk ndodhë deri në fillim të vitit të ardhshëm, me zjarrfikësit do të diskutojmë opsionet tjera.</p>	<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Të gjitha institucionët publike në kompetencë të Komunës, parqet dhe bizneset private, do të obligohen, përmes një rregulloreje komunale, të instalojnë kamerat CCTV.</p>	<p>Sipas kërkesës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi, kamerat dhe qendra e kontrollit të tyre i është dorëzuar Policisë së Kosovës. Megjithatë, kemi bashkëpunuar ngushtë me policinë në këtë çështje. Kemi pranuar projektin prej policisë se Kosoves për vendosjen e kamerave në udhëkryqet e komunikacionit me qëllim që të rrisim sigurinë dhe kontrollin dhe poashtu na kanë dorëzuar projektin për vendosjen e kamerave në hapësira publike të prioritizuara sipas rrezikut. Kemi proceduar thirrjen për vendosjen e kamerave dhe kemi buxhetuar me tepër se 1 mil euro për vendosjen e kamerave.</p>	<p>Gjysme i përbushur</p>

Ndërtimi i Parkut të Qenve, të ngjashëm me Parkun e Arinjëve, në të cilin do të strehohen qentë endacakë.

Komuna ka ndarë 10 hektarë tokë në fshatin Slivovë për ndërtimin e Qendrës së Kafshëve, me theks në qentë me dhe pa pronarë, e që do të jetë park rajonal, pasi që përfshinë edhe komunat fqinjë me Prishtinën. Poashtu komuna është në fazën e perfundimit për ndërtimin e qendrës për qentë endacake në Hajvali (punët ishin ndërprerë në prill të 2022 nga kompania, me arsyetimin e ngritjes së çmimeve). Për ndërtimin e Qendrës së Kafshëve komuna ka mbajtur dy takime regjionale (me komunat e tjera) për t'i harmonizuar veprimet. Jemi në fazën përfundimtare të nënshkrimit të Marrëveshjes Rajonale për Bashkëpunim Ndër-Komunal, e që do të jetë marrëveshja e tillë e parë e nënshkruar ndonjëherë në Kosovë nga shumë komuna dhe me shumë veprime, përfshirë edhe kujdesin ndaj qenve. Njëherazi nga maji i 2022 janë ngritur nga 5 në 23 pika të ndryshme në qytët ku vendoset ushqimi për kafshë me qëllim të shmangies së rastëve të sulmeve të qenve ndaj qytëtarëve, dhe jemi në proces të ngritjes të edhe një pike.

Janë ndërmarrë edhe një mori veprimesh tjera, që në total mbërrin vlerën prej rreth një milion eurosh, të shpenzuara dhe të zotuar, e që është katërmëdhjetëfishi i cili është japë ndonjëherë nga cilido autoritet lokal.

I filluar

<p>Lansimi i një programi masiv që do të ketë për synim krijimin e 250 hektarëve të hapësirave të gjelbra dhe mbjelljen e 800.000 drunjëve fidanore brenda 4 viteve.</p>	<p>Brenda vitit 2022, duke marrë parasysh sezonën e mbjelljeve (Mars- Korrik, dhe Tetor –Dhjetor), janë mbjellur rreth 15,000 cope fidane (gjetherrnëse, gjethëmbajtëse dhe shkurre dekorative). Këto mbjellje janë realizuar me ane të kontratave të Drejtorisë së Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve dhe donacioneve. Për të arritur deri tek synimi i mbjelljes së 800,000 drunjëve fidanore, përvëq kontratave të gjelbërimit, numri i drunjëve do të rritet me anë të projekteve të parqeve të cilat janë veqse në proces të realizimit. Gjithashtu, Drejtoria ka hartuar projektin për mbjellje masive përgjatë hyrje-daljeve të rrugëve në Prishtinë dhe përgjatë Autostrades “Dr. Ibrahim Rugova”. Ky projekt perfshin rreth 21,000 drunjë, i cili është në proces të marrëveshjes me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për realizim sa me të shpejtë të këtij projekti. Në plan të veprimit për vitet e ardhshme përpunohen vazhdimësisht së projekteve dhe kontratave të lartcekura, është edhe pyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara të Prishtinës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Lidhja e zonave të gjelbërta përmes krijimit të korridorëve të gjelbër, të cilët do t’u mundësojnë qytetarëve lëvizje nga një pikë e qytetit në tjetrën, kryesisht përmes korridorëve që janë të gjelbër.</p>	<p>Deri më tani janë krijuar korridore të gjelbërta në rr. “Tirana” (e cila lidhë Arbërinë me Lakrishtë), rr. “Dëshmoret e Kombit, (në proces) lidhja e Qendrës deri të rrethi i Flamurit), rr. “Arbënor e Astrit Dehari” (lidhja e Mat - Lagjja e Spitalit- Ulpianë), Rr.” Eqrem Qabej” (në proces projekti që lidh Bregun e Diellit –Qendër), Hapësirat afër rreth rrotullimit të rr. “Muharrem Fejza”, -Korridori i Gjelbër përgjatë shkallëve të Arbërisë. Në kuadër të festivalit të artit dhe arkitekturës “Manifesta Biennale” është inauguruar Korridori i gjelbër prej Tulltores deri te rrethrotullimi i Arbërisë (që lidh Kodrën e Trimave- Arbërinë-Tophanen-Qendrën). Gjate pjeses se dyte te sezonit te mbjelljeve (Tetor – Dhjetor) jane realizuar koridoret e gjelbërta përgjate rrugeve: “Agim Ramadani”, Rruga B, “Fatime Sokoli”, dhe rr. “Vellezrit Fazliu” e cila pritet te realizohet mbrenda javes ku lidhet qendra me lagjen e Kodres se Trimave.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Krijimi i shiritit të gjelbër në çdo lagje, i cili do të përbëhet nga bimë të kultivuara.</p>	<p>Shiriti me bime të kultivuara ka filluar si projekt në qendër të qytetit ku janë mbjellur lule shumëvjeqare dhe bime mjeksore, përmes këtyre bimeve synohet të rritet kualiteti i biodiversitetit në qytet. Ky projekt do të vazhdojë edhe nëpër lagjet e Prishtinës në vitin e ardhshëm. Projekt i ngjajshëm me bime të kultivuara do të realizohet së shpejti në lagjen Ulpiana, ku në bashkëpunim me OSCE, dhe YARL do të krijohen disa 'kopshte për komunitet' ku qytetarët do mund të mbjellin bimë të kultivuara.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ofrimi i lehtësirave tatimore për kompanitë që rrisin numrin e automjeteve "miqësore/elektrike" ndaj mjedisit.</p>	<p>Është miratuar rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë afarsite të udhëtarëve me taksë. Përmes kësaj rregulloreje, planifikohet të rregullohet shërbimi i taksive në Kryeqytet. Ndër masat kryesore të kësaj rregulloreje do të jenë veturat elektrike, të cilat do të ndikojnë dukshëm në përmirimin e mjedisit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Lansimi i një programi urgjent për eliminimin e azbestit, nga kulmet e ndërtesave të shumta, dhe mundësimi i kulmeve solare për energji solare.</p>	<p>Pasi që në Kosovë nuk ka kompani të licencuar për largimin e azbestit, Kryeqyteti ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi me MM, në mënyrë që FSK të bëjë largimin nga objektet në rastet emergjente. Përmes një kompanie të huaj, është larguar azbesti në ndërtesat me nevojë për Bienenal MANIFESTA, dhe tani jemi në proces të largimit të azbestit, përmes FSK-së, në dy objekte tjera. Jemi në proces të trajnimit dhe licencimit të një numri të zjarrfikësve, në mënyrë që në të ardhmen zjarrfikësit të monitorojnë dhe kontrollojnë aspektin profesional të largimit të azbestit, derisa një kompani ordinere do të merrej me punën fizike. Deri tani, dy zjarrfikës vetëm se kanë marrë pjesë në një trajnim. Gjithashtu në master planin e menaxhimit të mbeturinave është paraparë qendra për grumbullim dhe trajtim të azbestit si lëndë e rrezikshme.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Lansimi i projektit për një fabrikë të riciklimit të mbeturinave inerte dhe organike.</p>	<p>Projekti për fabrikën e riciklimit të mbeturinave inerte është planifikuar dhe përfshirë në Buxhetin e vitit 2023.</p> <p>Ndërsa, projekti për riciklimin e mbeturinave organike Qendra Komposte në Butovc është lançuar.</p>	<p>I përbushur</p>
<p>Rigjenerimi i rrjetit të grumbullimit të mbeturinave. Ndarja e qytetit në pesë zona, për menaxhim të mbeturinave.</p>	<p>Kemi filluar përpilimin e rregullores së re për Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Prishtinës e cila e rregullon ndarjen e zonave. Me vendim të kryetarit është formuar grupi punues për hartimin e rregullores.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Caktimi i lokacionit për pikën grumbulluese të mbeturinave të vëllimshme (orendi, tavolina, karrige, televizor dhe pajisje të tjera të amvisërisë)</p>	<p>Ka filluar studimi i fizibilitetit për lokacionet potenciale për qendrën e grumbullimit si dhe është projektuar dhe buxhetuar për vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndryshime në kategoritë e shpenzimeve të buxhetit, ku pjesëmarrjen kryesore do ta kenë investimet kapitale. Kjo kategori do të jetë mbi 50% e buxhetit total.</p>	<p>Kategoritë buxhetore caktohen nga Ministria e Financave! Komuna e Prishtinës për vitin 2023 ka 40 milion EUR të ndara për investime kapitale. Nëse marrim parasysh edhe bartjen e të hyrave vetanake, atëherë investimet kapitale tejkalojnë 50% të buxhetit total.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ofrimi i informatave orientuese të qasshme për turistët, sidomos të dhëna mbi të kaluarën e atraksioneve kulturore dhe atyre historike.</p>	<p>Deri më 31 qershor 2022 komuna ka bërë përgaditjet për hapjen e festivalit të artit dhe artitëkturës “Manifesta Biennale”. Poashtu për hapjen e festivalit “Gastronomy festival”. Për festivalin e parë janë paraparë 44 lokacione për zhvillimin (vizita) e aktivitetëve dhe që të gjitha janë shënëzuar për vizitorët. Poashtu në sheshin “Zahir Pajaziti” është vendosur një kiosk nga ku ofrohen të dhëna për Prishtinën dhe objektët/hapësirat që mund të vizitohen. Kemi filluar procesin për zyrën informative turistike, në bashkëpunim me Swiss contact, ku është përzgjedh projekt i ideor, dhe tani vazhdohet me procedurat nga Swiss Contact sipas marrëveshjes.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Funksionalizimi i Qendrës Informative të Turizmit në sheshin “Zahir Pajaziti” dhe krijimi i dy qendra të tjera të reja, njëra në Aeroportin e Prishtinës dhe tjetra tek Stacioni i Autobusëve. Këto qendra do të punojnë edhe gjatë vikendit.</p>	<p>Marrëveshja e Bashkëfinancimit me Swiss Contact është nënshkruar me datën 17.08.2022 dhe në vete përmban, në mes tjerash, rifunksionalizimin dhe ndërtimin e Qendrës Turistike në qendër të qytetit si dhe krijimin e dy qendrave mobile, njëra në Aeroportin e Prishtinës dhe tjetra tek Stacioni i Autobusave. Përmes kësaj marrëveshjeje Kryeqyteti do të ketë tri (3) pika të reja informuese: në shesh, në stacion të autobusëve dhe në aeroport deri në fund të viti.</p> <p>Është përzgjedhur projekt i ideor për zyrën informative, dhe më pas vazhdohet me procedura të tjera, këto procedura kryen Swiss Contact sipas marrëveshjes që kemi.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Krijimi i katalogut të shtypur për zonat/objektet historike dhe kulturore të Prishtinës.</p>	<p>Kemi kërkuar në marrëveshjen e lartëcekur me SwissContact të parashihet edhe krijimi i katalogjeve të ndryshme për zonat/objektet historike si dhe ato kulturore në përgjithësi.</p> <p>Përmes fazës së parë të subvencioneve në fushën e kulturës, kemi mbështetur unionin e turizmit të Kosovës i cili është në përgatitje e sipër katalogun informativ për zonat /Objektet historike dhe kulturore.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i një aplikacioni mobil për zonat e caktuara historike/kulturore të Prishtinës.</p>	<p>Kemi mbështetur përmes subvencioneve “Cactus” për krijimin e aplikacionit për zonat e caktuara historike/kulturore të Prishtinës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Përgatitja e një harte informuese që i përfshin të gjitha pikat/zonat atraktive me shpjegimet përkatëse, numrat emergjent, taksitë (me çmime referentë) dhe linjat e autobusëve së bashku me oraret.</p>	<p>Ne kemi hartën informuese në gjuhë Shqipe, Angleze, Frenge Gjermane dhe Italiane, mirëpo duhet të plotësohet me linjat e autobuseve, kontakte, numrat emergjent.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Vendosja e rreth 10 panele turistike (një e tillë në aeroport) për orientim nëpër pikat kryesore turistike të qytetit, së bashku me tableta tjera informuese</p>	<p>Totemat (Panelet turistike) janë të vendosura në qytet, ndërsa në aeroport akoma nuk kemi vendosur një panel të tillë.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Themelimi i Teatrit të ri të Qytetit, ndaras nga Teatri “Dodona”</p>	<p>Teatri i Ri i Kryeqytetit (projekti ideor) është në fazën e planifikimit buxhetor për vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i “Galerisë së Qytetit”.</p>	<p>Ndërtimi i Galerisë së Kryeqytetit (projekti ideor) është në fazën e planifikimit buxhetor për vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i “Sallës Multifunktionale Kulturore”te Pallati i Rinisë.</p>	<p>Në kuadër të Sallës Multifunktionale është punuar në dy drejtime. E para, në kuadër të Teatrit të Operas dhe Baletit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës është punuar që në termat e referencës të përfshihen edhe ambientet multifunktionale si pjesë e tërësisë së kompleksit. E dyta, në kuadër të ndërtimit ekzistues pallat i rinisë tek hapësira e Sallës së Madhe ka filluar hartimi i termave të referencës për kthyerjen e saj në hapësirë multifunktionale për sektorin ICT. Është në fazën e planifikimit buxhetor për vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Themelimi i “Muzeut të Artit”.</p>	<p>Është në fazën e planifikimit buxhetor për vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>

Themelimi i “Orkestrës së Qytetit”.	Në hapësirat e Tulltores jemi duke dizajnuar një sallë për muzikë simfonike me një kapacitet prej 350 personave, e cila do të jetë në shërbim të orkestrës së qytetit.	I filluar
Themelimi dhe organizimi i Festivalit Multikulturor “Pranvera në Prishtinë”	Ky festival ka nisur për here të parë të organizohet në Prishtinë. Në 2022 është organizuar për tri ditë rresht, 20-22 maj, i njohur ndryshe si festivali i artit në rrugë, ku komuna ka mbyllur rrugen afër shkollës “Elena Gjika” dhe Xhorxh Bush (afër Katëdrales). Aktivitetët në kuadër të festivalit kanë përfshirë pikturimin, futboll të vogël, basketboll dhe në përdorimin e trotinëtëve dhe bicikletave.	I përmbushur
Subvencionimi dhe vazhdimi i festivaleve “Verë n’Dimër”, “Akull n’Verë” dhe “Sunny Hill”	Festivali “Sunny Hill” është mbështetur nga komuna, nuk është organizuar festivali “Akull në verë”, ndërsa festivali “Verë në Dimër” është mbajtur gjatë dhjetorit 2021 e deri më 3 janar 2022. Jemi duke u kordinuar për festat e fundvitit, është në proces organizimi i festivalit verë në dimër.	Gjysëm i përmbushur
Teatri “Dodona” duhet të ketë buxhet të rregullt vjetor për shfaqjet teatrore.	Teatri “Dodona” është mbështetur financiarisht nga Komuna, por nuk ka buxhet të rregullt nga komuna e Prishtinës Teatri është në linjë buxhetore në kuadër të Drejtorisë së Kulturës.	I përmbushur
Themelimi i së paku katër Qendrave Kulturore me bazë në komunitet, në lagjet “Dardania”, “Bregu i Diellit”, “Qendra”, dhe “Kodra e Trimave”.		Nuk ka filluar
Themelimi i Shkollës së Mesme të Artit në Prishtinë.		Nuk ka filluar
Funksionalizimi i Qendrës Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës.	Qendra Kulturore e fëmijëve të Prishtinës është institucion vartës i drejtorisë së Kulturës dhe funksionon në Pallatin e rinisë.	I përmbushur
Përfshihet lënda e Arteve Dramatike në kurrikulat e arsimit fillor dhe të mesëm.		Nuk ka filluar
Zgjerimi i degëve të Bibliotekës Komunale “Hivzi Sylejmani” në lagje të tjera të qytetit, sidomos në “Kodrën e Diellit”, “Arbëri”, “Kodrën e Trimave”, “Kolovicë”, “Emshir”, dhe “Mat”.	Në lagjen Kodra e Trimave, puna tek ndërtimi i Bibliotekës është ndërprerë me kërkesë të punëkryesit për shkak të ngritjes së çmimeve. Momentalisht është në fazën e kalkulimit të punëve të mbetura për të vazhduar me prokurim të ri për të përzgjedhur punëkryesin për punët e mbetura.	I filluar
Digjitalizimi i Sistemit Shëndetësor të Prishtinës, përmes funksionalizimit të plotë të Sistemit Informativ të Shëndetësisë (SISH)	Kemi nënshkruar Memorandumin e Bashkepunimit me Solabrate për fillimin e pilot projektit për digjitalizimin e sistemit shëndetësor.	I filluar

<p>Zonimi i qytetit dhe listimi i pacientëve, që secili pacient ta ketë mjekun e vet.</p>	<p>Prishtina e ka hartën zonale në të cilën janë përcaktuar cilat lagje i takojnë cilës zonë dhe cila është QMF përgjegjëse për atë zonë.</p> <p>Duhet zgjidhur çështja e shënimit të adresave në dokumente të identifikimit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Përfundimi i ndërtimit të QMF-së në lagjen e Veternikut.</p>	<p>Komuna ka aprovuar 60,000 euro para shtesë për t'u mundësuar finalizimi dhe funksionalizimi i Qendrës të Mjekësisë Familjare në Veternik. Para ndarjes së këtyre mjetëve Komuna ka themeluar një komision për të bërë verifikimin e gjendjes në terren dhe për të parë nivelin e përbushjes së kontratës. Punët në terren janë në përfundim e sipër.</p>	<p>Gjysëm i përbushur</p>
<p>Ndërtimi i një QMF-je të re në lagjen “Mati 2”.</p>	<p>Duhet të bëhen hulumtime për nevojat e qytetarëve. Po ashtu, duhet pritur statistikat e dalura nga regjistrimi i popullësisë për të parë nevojat reale për ndërtimin e një QMF-je të re.</p>	<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Në Prishtinë do të ketë së paku nga katër kabinetë të rentgenografisë dhe mamografisë.</p>	<p>Është blerë mamografi i tretë. Njëri është i vendosur në QKMF dhe tjetri në QMF 5 në Ulpianë, kurse i treti do të vendoset në Veternik.</p>	<p>Gjysëm i përbushur</p>
<p>Krijimi itetë ekipeve mjekësore mobile (të përbërë nga një mjek dhe dy infermierë). Secila nga katër qendrat e mëdha do të ketë nga 2 ekipe. Dy ekipe do të jenë në QKMF, dy ekipe në QMF tek “Medreseja”, dy ekipe në QMF në lagjen “Dardania”, dhe dy ekipe në QMF në lagjen “Bregu i Diellit”.</p>	<p>Më 01.03.2022 ka filluar mjekimi kronik në QMF në lagjen e Muhaxherëve. Këtu shërbimet ofrohen 12/7 ditë. Për 9 muaj të këtij viti ky shërbim ka ofruar 7462 vizita mjekësore apo mesatarja mujore 829 vizita të pacientëve. Kurse, 29866 shërbime mjekësore të cilat janë dhënë në shtëpi apo 110 shërbime mjekësore në ditë.</p> <p>Kemi blerë autoambulacapër këtë shërbim prej të cilave katër i janë dorëzuar shërbimit dhe tani pritet edhe dorëzimi i autoambulancës së pestë. Gjatë pesë ditëve janë dy ekipe, kurse në fundjavë një ekip.</p>	<p>75% i përbushur</p>
<p>Shërbimi i fizioterapisë në Qendrat Mjekësore (fillimisht në lagjen “Arbëria”).</p>	<p>Jemi duke analizuar metodologjinë dhe kemi ardhur në përfundim që këtë shërbim do ta mbulojë në tëresi Spitali i Ri i Prishtinës. Me ligjet në fuqi, fizioterapia është shërbim që ofrohet në shërbimin sekondar dhe terciar.</p> <p>Ky shërbim do të shqyrtohet si pjesë e shërbimeve sekondarë.</p>	<p>Nuk ka filluar</p>

<p>Themelimi i Spitalit Rajonal të Prishtinës, përmes ndërtimit të një spitali të ri apo shfrytëzimit të hapësirave të QKUK-së.</p>	<p>Më 23 qershor zyrtarët e komunës kanë prezantuar studimin e fizibilitetit për ndërtimin e spitalit të Prishtinës si dhe skicen për dukjen e jashtme të objektit. Komuna ka marrë mbështetje nga organizata turke TIKA dhe nga Emiratët e Bashkuara Arabe për mbështetjen e këtij projekti. Zyrtarët e Prishtinës kanë zhvilluar 5 takime me ministrin e MSH me qëllim të koordinimit të masave në drejtim të konkretizimit të këtij projekti. Komuna ka ndarë lokacionin.</p> <p>Ka filluar faza e dytë e hartimit të planit detal. Prishtina ka planifikuar në buxhet për fillimin e ndërtimit të këtij spitali në vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës do të themelojë një institut për nevojat e qytetarëve të Prishtinës.</p>	<p>Kemi përgatitur një draft memorandum me IKSHP i cili i hap rrugë ndërtimit të shërbimit Mikrobiologjik të Qytetit i cili pastaj do të themelohet përmes Kuvendit të Kreqytetit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Orientimi i Trafikut në Unazën e Jashtme të Prishtinës.</p>	<p>Ne bashkepunim me BERZHin kemi përgatitur riorganizimin e linjave/shtimin e linjave të reja të transportit publik dhe kemi organizuar që nepermjet rregullores së Prishtina Parking-ut të implementohet formati I parkingjeve park and ride.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Promovimi i biçikletave dhe mjeteve të tjera alternative të transportit.</p>	<p>Në kuadër të festivalit “Pranvera në Prishtinë” një ditë i është kushtuar promovimit dhe përdorimit të biçikletave dhe trotinetëve. Në projektin e Unazës së Mesme, përgjatë gjithë trasës së saj është paraparë edhe shtegu i biçikletave.</p> <p>Implementimi i projektit të shtigjeve të biçikletave në Taukbashqë, i cili ka për qëllim vetëdijësimin e përdorimit të biçikletave dhe mjeteve tjera alternative. Kemi përgatitur projektin 100 km shteg të biçikletave i cili parasheh ndërlidhjen e gjitha zonave të kryeqytetit.</p>	<p>I përfunduar</p>
<p>Fasadimin e ndërtesave</p>	<p>Ka përfunduar fasadimi dhe rregullimi gjeneral i ndërtesave në lagjen “Ulpiana” të njohura si katër soliterët. Komuna parasheh në vazhdimësi të intervenojë në fasadimin e ndërtesave me qëllim të ngritjes së performancës energjetike të tyre.</p>	<p>Gjysëm i përmbytur</p>

<p>Hartimi i planeve të veçanta të menaxhimit për zonat e rekreacionit brenda lagjeve</p>	<p>Në kuadër të hartimit të dokumenteve planore përcaktohet mënyra e menaxhimit të zonave të rekreacionit brenda lagjeve. Kemi përfunduar në lagjen Kodra e Trimave hapësirën recreative në shërbim të lagjes si dhe kemi filluar krijimin e kendeve te gjelberta ne rruget Bedri Gjini.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimin dhe zgjerimin e artit publik.</p>	<p>Në kuadër të festivalit të artit dhe arkitekturës “Manifesta Biennale” janë mbajtur sesionë të veçanta të prezantimit dhe ekzekutimit të punimeve në kuadër të konceptit “arti publik”. Këto janë shtrirë në disa zona të Prishtinës, veçmas në rrugën “B”, në lagjen “Arbëria” në lagjen afer “Madrese” si dhe përgjatë rrugës “Eqrem Qabej. Edhe këtë vit janë mbështetur projekte për zgjerimin e artit publik përmes subvencioneve).</p>	<p>Gjysëm i përmbytur</p>
<p>Konservimi dhe rigjenerimi i pikave ikonike urbane “retro”, si “Soliterat”, “Kurrizi”, “Qafa”, si dhe ndërtësat ikonike si “Pallati i Rinisë”, “Biblioteka Kombëtare” dhe “Ndërtësa Gërmia”.</p>	<p>Kemi inicuar konkurs dhe prokurimi për projekt-dizajnin e Kurrizit është përmbyllur. Është nënshkruar kontratat për hartimin e projektit kryesor pas të cilët do të bëhet prokurimi për zhvillimin e punimeve.</p> <p>Pallati i Rinisë ka filluar me rikthimin e zonës se Atriumit dhe është duke u shfrytëzuar si hapësirë për lojë dhe tavolina pinpongu. Janë larguar strukturat për reklamim me c’rast kjo hapësirë është kthyer në shërbim të publikit dhe në të njëjtën kohë ka kotnibuar në kthyerjen e identitetit fillestar të ndërtesës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i hapësirave të reja publike për art, kulturë, festival dhe aktivitete të tjera rekreative.</p>	<p>Në kuadër të festivalit të artit dhe arkitekturës “Manifesta Biennale” hapësira të reja janë krijuar përgjatë hekurudhës, afër “Termokosit” si dhe në zonën historike të Prishtinës.</p> <p>Gjithashtu është krijuar nje hapësirë e re për festivale dhe aktivitete tjera kulturore në kompleksin e Tulltores.</p>	<p>I përmbytur</p>

<p>Krijimi i oazave natyrale në pika të ndryshme të qytetit me qëllim të rigjenerimit të florës dhe faunës.</p>	<p>Gjate këtij viti, në qytet janë krijuar dhe rigjeneruar disa oaza të gjelberta në zona të ndryshme të qytetit si në: Aktash, Bregu i diellit, Mat, përgjatë rrugëve. “Agim Ramadani”, “Muharrem Fejza”, “Sylejman Vokshi, “Tirana”, në Tulltore, në Parkun “Adem Demaci”, Parkun mbi sallën 1 Tetori, ne oborrin e Fakultetit të Historisë, lagjen Qafa (ruga UCK). Drejtoria ka për qëllim realizimin e planit të rigjenerimit të bimësisë në rrethrotullimet e qytetit, projekt i cili veqse është realizuar në disa prej tyre si në: rrethrotullimi i rruges C, B, rrethi I madh në Veternik, derisa të tjerët janë në proces. Në lagjen Kodra e Trimave, në mes të rrugëve “Bedri Gjini”, dhe “Carraleva” është krijuar oaza e gjelbërt rekreative.</p>	<p>Gjysëm i përbushur</p>
<p>Mirëmbajtja e rrugëve do të decentralizohet në katër zona.</p>	<p>Në buxhetimin e vitit 2023 është paraparë rritja e buxhetit për mirëmbajtjen e rrugëve, ku do të kemi me tepër lote dhe përfshirjen e më shumë rrugëve në krahasim me vitet e kaluara, ku janë përfshirë rrugë në zonat urbane e rurale, gjithashtu parkingje, plato etj. Ndarjen e mirëmbajtjes e kemi ndarë në 6 zona, me monitorim 24 orë në kuadër të zonës.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i shtigjeve për persona aftësi të kufizuar</p>	<p>Në kuadër projekteve të platformave ndërlidhëse mes Arbërisë dhe Zonës Qendër si dhe Bregut të Diellit dhe Zonës Qendër janë përgatitur/dizajnuar dy projekte që do t’ju mundësojnë personave me aftësi të kufizuar lëvizjen e lirë e të sigurtë në këto hapësira.</p> <p>Në ndërkohë, Drejtoria e Administratës dhe Drejtoria për Mirëqenie Sociale kanë lansuar programin për qasje komunale për personat me aftësi të kufizuar brenda objekteve të komunës së re dhe të vjetër, duke ju ofruar shtigje taktile për personat e verbër, standardizimin e pjerrinave për përdoruesit e karrocave, etj - për të vazhduar tutje në objektet e tjera komunale.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Zgjerimi i Rrjetit të Ngrohjes Qendrore.</p>	<p>Projekti i ndarë në dy pako tenderuese, i financuar nga KFW dhe Termokosi synon të bëj lidhjen në rrjetin e ngrohjes qendrore të objekteve të cilat gravitojnë afër rrjetit primar, por të cilat deri më tani nuk kanë qenë pjesë e sistemit të ngrohjes qendrore (dendsifikim i rrjetit); Kemi bërë zgjerimin e rrjetit të ngrohjes qendrore në lagjen e reja (Rruga Muharrem Fejza, Lagjja Arbëria dhe Qender (parku I qytetit)</p> <p>Poashtu, do të bëhet rehabilitim i rrjetit të vjetër, me gypa të rinjë të paraizoluara. Lidhja në rrjetin e ngrohjes qendrore të objekteve të cilat gravitojnë afër rrjetit primar, por të cilat deri më tani nuk kanë qenë pjesë e sistemit të ngrohjes qendrore (dendsifikim i rrjetit); Rehabilitim i rrjetit të vjetër, me gypa të rinjë të paraizoluara. Deri më tani janë kryer këto pjesë të kontratës:</p> <p>Instalimi I rrjetit primar me gatësi L=7650m trase (15040m gyp) në lagjen Muharrem Fejza për furnizim të 141 objekteve, kryesisht për banim kolektiv dhe të SHMU Pavarësia.</p> <p>Instalimi I rrjetit për densifikim me gjatësi 2800 m trase (560m gyp)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ulpiana- 23 objekte; • Dardani-13 objekte; • Qender-49 objekte (për pesë objekte rrjeti nuk ka përfunduar ende) • Bregu I Diellit-1, 1 objekt; <p>Instalimi I rrjetit primar me gatësi L=232m trase (464m gyp) në ArbëriRehabilitimi I rrjetit të vjetër, gypa nga DN32 deri DN 450, me gjatësi 5050m trase (10100m gyp) është realizuar në masën 95%.</p> <p>Ndërsa për rehabilitimi të nenstacioneve</p> <p>Të planifikuara:</p> <p>333 në nstacione të reja</p> <p>225 nënstatione për rehabilitim</p> <p>Ndërtimi I dy rezervuarëve të nxehtësisë me kapacitet 2x400m³ ujë të nxehtë;</p> <p>Instalimi I pompës së tretë transportuese HES – HRS;</p> <p>Instalimi I pompës së pestë qarkulluese për rrjetin e qytetit;</p> <p>Instalimi I sistemit për trajtim të ujit ;</p> <p>Deri më tani janë kryer këto pune:</p> <p>Jan instaluar 63 nënstatione të reja në Mati-1, 47 prej tyre janë funksionalizuar,</p> <p>Janë rehabilituar 103 nënstatione në rrjetin ekzistues.</p> <p>Është duke u punuar në themelet e rezervuarëve të nxehtësisë. Kjo punë duhet të përfundojë deri në fund të dhjetorit 2022.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p> <p>Mbi 70%</p>
<p>Krijimi i zonimit të vendeve të parkimit, me lagje, ku qytetarët aplikojnë për leje vjetore për parkim në lagje.</p>	<p>Në pjesën e lagjeve të qendrës dhe në lagjen “Bregu i Diellit”, “Dardania”, “Ulpiana” dhe “Arbëria” është kryer zonimi dhe shenjzimi dhe poashtu mundësia që qytetarët të aplikojnë për leje vjetore të parkingut.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>

<p>Shpeshtimi i linjave të autobusëve nga qendra, drejt fshatrave dhe anasjelltas.</p>	<p>Bashkë me BERZH-in dhe Trafikun Urban jemi duke punuar në ri-organizimin e linjave ekzistuese dhe shtimin e linjave të reja. Kjo mundësi do të ofrohet nga flota e re e Trafikut Urban (plus 30 autobusë të rinj) dhe nga përfshirja e sektorit privat në ofrimin e shërbimeve të autobusëve. Do të ofrohet bileta e integruar, ku qytetarët do të kenë mundësinë të shfrytëzojnë 1 biletë për linja të ndryshme brenda nje afati të caktuar. Ky sistem integron linjat e qytetit, por edhe ato të periferisë.</p> <p>Nënshkrimi i kontratës për kredi të 30 autobusëve të rinj, duke përfshirë 6 prej tyre elektrik , pritet të nënshkruhet me BERZH me 15 dhjetor 2022.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i korridoreve të gjelbra të cilat i lidhin fshatrat me zonat e gjelbra të qytetit.</p>	<p>Projektet janë planifikuar dhe përfshirë në buxhetin e vitit 2023. Kemi hartuar koncept projektin qe lidh Kodren e Trimave me Bernice te Poshtme dhe kemi filluar implementimin e mbjelljes se drunjeve qe do te ben kete lidhje.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i hapësirave rekreative në fshatrat e Komunës së Prishtinës.</p>	<p>Janë krijuar dhe përruar 4 fusha sportive të cilat kanë krijuar hapësira rekreative në fshatrat (Grashticë, Llukar, Bardhosh dhe Kodër të Trimave) Është ndarë buxheti per krijimin e parkut dhe eshte krijuar projekti konceptual I parkut ne zonen Barilevë–Drenoc.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Hapja e tualetëve publikë. Këta tualetë do të kenë një hapësirë të qasshme, me drita, ujë dhe do të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme.</p>	<p>Është bërë projekt-dizajni unik, pjesë e një set-i të mobileve urbane të cilët në tërësinë e vet do të ndikojnë në krijimin e një identiteti të vecantë. Në kuadër të kësaj janë përfshirë kiosqet, pritoret e autobusave dhe tualetët publik.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i planit pesëvjeçar rregullativ për masat e energjisë eficiente.</p>	<p>Jemi përzgjedhur si fitues nga GIZ-i për hartimin e planit komunal për energji dhe klimë.</p> <p>Gjithashtu, kemi nënshkruar kontratë/kredi me EBRD (5 mil EUR) për të renovuar ndërtesat e sektorit publik në Komunën e Prishtinës, duke instaluar masa moderne të energjisë eficiente.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Riparimi i ndërtesave publike për të siguruar përdorim të energjisë eficiente, në objektet e shkollave fillore dhe të mesme, qendra shëndetësore, çerdhe, administratë publike, në ndërtesa publike të kulturës.</p>	<p>Ka përfunduar fasadimi dhe rregullimi gjenëral i ndërtesave në lagjen “Ulpiana” të njohura si katër solitëret dhe tërë investimi bëhet duke ju përshtatur masave të efqiencës së enërgjisë. Kemi funksionalizuar shtëpinë e Hivzi Sylejmanit që shërben si rezidencë për artistë</p>	<p>I filluar</p>

<p>Zëvendësimi i llambave ineficiente me ndriçuesit me teknologji LED në sistemin e ndriçimit publik dhe në ndërtësa publike.</p>	<p>Me projektin e mirëmbajtjes së ndriçimit publik jemi duke bërë zëvendësimin e tyre, ku deri me tani ndriçimi publik është i mbuluar me teknologji LED deri në 90%.</p> <p>Pjesa tjetër prej 10%, pritet të zëvendësohet me projektin e Zgjerimit të Ndriçimit Publik deri në fund të vitit 2023.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Lëshimi i lejeve të ndërtimit bazuar edhe në kriteret që do vendosen për objekte që u përmbahen kushteve të efijencës së energjisë.</p>	<p>Me vendim të Kryetarit është krijuar Kolegjiumi për kushte ndërtimore. Gjithashtu në kuadër të drejtorisë së urbanizmit në bashkëpunim me expert gjerman është në proces hartimi i rregullores për masat eficiente që duhet ti gëzojë cdo ndërtesë.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Së paku 20-25% e kërkesës për ngrohje të ujit në ndërtesa publike të mbulohet nga energjia e ripërtërishme.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Përgaditja e projekt-propozimit për instalimin e paneleve solare në Stacionet e Autobusit (pikat pritëse në qytet). Energjia e prodhuar nga sistemet solare, do të shërbejë për ndriçimin e këtyre pikave, si dhe do të shërbejë si pikë për mbushjen e telefonave gjatë kohës së pritjes.</p>	<p>Eshtë përpiluar projekt-propozimi i cili parasheh panelet solare dhe jemi në proces të përzgjedhjes së dizajnit.</p> <p>Po ashtu me GIZ është fituar granti për projekt-propoziminin "Solar Parking Prishtina. Në vlerë total 70,000 Euro.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Instalimi i matësit të energjisë termike, duke ndikuar në shfrytëzim më racional të energjisë termike.</p>	<p>Projekti i vendosjes së matësve të energjisë termike po vazhdon me dinamikë të shtuar. Eshtë përfunduar mbi 60% e projektit – ne të gjitha lagjet e Prishtinës duke përfunduar mbi 240 objekte (10025 njesi banesore)</p> <p>Jane instaluar mbi :</p> <p>44000 valvula</p> <p>35600 alokatore</p> <p>njesore ne te gjitha lagjet e Prishtinës – ne mbi 10025 banesa</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>

<p>Ndërtimi i infrastrukturës për dyfishim të kapaciteteve prodhuese dhe rrjetit transmetues të kogjenerimit nga 140 Mët – 280 Mët.</p>	<p>Ka filluar realizimi i studimit paraprak, i cili do t'i hapë rrugë realizimit të këtij projekti kapital, që do të mundësojë zgjerimin e mëtutjeshëm të rrjetit të ngrohjes, gjë që do të ndikojë në uljen e konsumit të energjisë elektrike si dhe në uljen e ndotjes së ajrit si pasojë e shfrytëzimit të alternativave tjera ngrohëse.</p> <p>Realizimi i këtij projekti do të krijojë mundësinë, që kapaciteti aktual termik që NP "Termokos" mund të marrë nga KEK-u, nga 140 MËth të dyfishohet në 280 MËth.</p> <p>Projektit për dyfishimin e kapaciteteve dhe dekarbonizimin e sistemit të ngrohjes, që do të financohet nga Banka Evropiane për Investime (BEI) dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).</p>	<p>I filluar</p>
<p>Inicimi i projektit për furnizim me energji termike përmes energjisë diellore.</p>	<p>Projekti "Solar4Kosovo" – po hyn në fazën e fillimit të jetesimit të tij.</p> <p>Gjatë muajit Dhjetor do të nënshkruhet marrëveshjet financiare në mes të Komunes së Prishtinës, Ministrisë së Financave, Termokos dhe donatoreve.</p> <p>Si një nga projektet më të mëdha në fushën e energjisë solare në Evropë, "Solar 4 Kosovo" do të ketë mundësinë e integritit të dy sistemeve: të energjisë solare me atë të kogjenerimit. Nëpërmes vendosjes së paneleve solare në një hapësirë prej 58 mijë metrave katrorë do të rriten kapacitetet për 50 MË për të furnizuar me ngrohje edhe 12 mijë konsumatorë të rinjë.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Inicimi i hartimit të planit të fizibilitetit, për pjesët e qytetit të cilat nuk janë të parapara</p>	<p>Do të trajtohet me Arkitektin e qytetit</p>	<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Përgatitja e infrastrukturës në qytet për makina elektrike</p>	<p>Në kuadrin e planit të mobilitetit kemi parapare edhe infrastrukturën në qytet për makina elektrike.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Vendosja e kamerave në çdo lagje.</p>	<p>Është projektuar, buxhetuar dhe tenderuar dhe për shkak të nevojës së ndryshimit të specifikimeve teknike aktiviteti është anuluar dhe pritet që së shpejti të ri tenderohet.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Vendosja e sensorëve të ndryshëm për të identifikuar ndotësit e ajrit, ambientit, dhe rrjedhjes së ujit dhe zhurmës.</p>	<p>Marrëveshja për 1000 sensorët akustikë është nënshkruar dhe implementimi i saj pritet pas miratimit të rregullores mbi ndotjen akustike, për të cilën jemi në proces.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i kiosqeve të vogla, të cilat shërbejnë për hot-spotë, mundësi të mbushjes së telefonave të mençur, mundësi të thirrjes telefonike</p>	<p>Është diagnostifikuar lista e kërkesave dhe lokacioneve në bashkëpunim me ofruesit e internetit në Kosovë. Pritet të nisë procesi i tenderimit.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Krijimi i kiosqeve, të cilat do të jenë interaktive (touch screen), do të ofrojnë informata për orarin e autobusëve, telefonat e institucioneve, ngjarje kulturore, reklama, dhe evente tjera</p>	<p>Pikat e reja informuese në Kryeqytet do të kenë edhe ekranë. Përveç kësaj, ekranët në stacion të autobusit dhe brenda autobusëve shfrytëzohen për të tilla informime. Ne pritoret master të vendosura të katedralja (formati A) planifikojmë të vendosim 2 monitore dhe një hartë që ofron të gjitha informatat për transportin publik.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ofrimi i hapësirave për promovim të start-upave që kanë në fokus digjitalizimin, qendrat edukative.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Zvogëlimi i borxheve ndaj Komunës.</p>	<p>Drejtoria e Urbanizmit ka nxjerrë listën e borxhlinjëve dhe është në fazën e angazhimit të Përmba-ruesëve të cilët do të procesojnë lëndët tutje. Është themeluar nga Kryetari komisioni për verifikimin e listës së borxhinjëve i cili ka për detyrë të paraqet zyres ligjore listën finale për permbarim)</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i Kopshtit Botanik.</p>	<p>Projekti i Kopshti Botanik është inicuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve i cili është trajtuar në projekt konceptual nga Banka Botërore dhe SuperEien në Fushën e Paqjes – Kolovicë. Për këtë projekt nacional pritet të bëhet plani i fizibilitetit dhe projekti kryesorë në vitin 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i së paku dy impianteve të reja për trajtimin e ujërave të zeza.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ndryshim-plotësimi i rregullores për linjat e Transportit Publik.</p>	<p>Rregullorja për linjat e transportit publik është hartuar në kuadër të planit të mobilitetit i cili parasheh funksionalizimin e 161 autobusëve (81 trafiku urban; 80 sektori privat), ku do të bëhet edhe licencimi i operatoreve privat. Drafti do të lansohet për degjim publik në fillim të vitit 2023.</p>	<p>I filluar</p>

<p>Ofrimi i shërbimit të transportit publik 24 orë në ditë në linjat urbane.</p>	<p>Kemi intervenuar në linjat 1A, 4, 3, 1, ku kemi zgjatur orarin e operimit deri në orën 24:00.</p> <p>Me projektin e ri-organizimit dhe shtimit të linjave të reja, në koordinim me BERZH-in do të implementohet formati i transportit publik 24 orë në linjat urbane.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Kontrata afatgjatë, subvencione, dhe lehtësi të tjera për operatorët privat të transportit urban.</p>	<p>Bashkë me BERZH-in dhe operatorët jemi duke punuar në krijimin e kontratave të reja (formati sikur TU/pagesa për km). Kemi përgatitur biznes planet për secilin operator privat me qëllim të ofrimit të financimit nga BERZH-i ose ndonjë banke komerciale potenciale tjetër me qëllim të modernizimit të flotes së autobusëve të cdo kompanie të sektorit privat.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ripërtirja e flotës së autobusëve, duke përfshirë edhe operatorët privatë, me zero përqind ndotje të ambientit, klimatizim, dhe hyrje/dalje me platformë lëvizëse për nënat dhe personat me karroca.</p>	<p>Në flotën e re të autobusëve të TU është paraparë që të kemi 6-8 autobusë elektrikë, si dhe pjesa tjetër e flotës do të jetë e re, që përmban elementet dhe pajisjet më moderne.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Lehtësimi i kushteve për shfrytëzim të transportit publik, edhe për personat me aftësi të kufizuara, duke instaluar pajisje sinjalizuese me zë dhe pajisje adekuate vizuale në autobus dhe stacione.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-qershor 2022 Komuna ka vazhduar praktikën e vendosur në mandatin e kaluar për ofrimin e transportit publik falas për pensionistët, dhe personat me aftësi të kufizuara.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Stimulimi i përdorimit të transportit publik, përmes krijimit të hapësirave për parking të veturave në hyrje të qytetit, ku çdo qytetar me biletën e parkingut, mund ta shfrytëzojë transportin publik.</p>	<p>Rregullorja Prishtina Parking nepermjet park and ride parasheh krijimin e hapësirave për parkingje në hyrje të qytetit dhe bileta e parkingut do të mundësojë shfrytëzimin e transportit publik në kryeqytet</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i objektit të ri të Qendrës për Punë Sociale.</p>	<p>Është përgatitur detyra projektuese e objektit të ri të QPS. Është përcaktuar lokacioni.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Kompletimi i QPS-së me staf adekuat profesional dhe administrativ, vetura, dhe me mjete të tjera logjistike.</p>	<p>Janë rekrutuar/angazhuar 13 punonjës të ri në QPS (përfshirë psikologë, zyrtarë social dhe zyrtarë teknik (voztës). Gjithashtu, QPS-ja është furnizuar me automjetet shtesë dhe logjistike përcjellëse.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Kontraktimi i shërbimeve nga OJQ-të e licencuara për ofrimin e shërbimeve sociale</p>	<p>Drejtoria për Mirëqenie Sociale ka shpallur thirrjen për mbështetje financiare për OJQ-të që ofrojnë shërbime direkte sociale profesionale, për të cilën kanë aplikuar më shumë se 50 OJQ të ndryshme. Nga kjo thirrje kanë përfituar 31 organizata, shuma totale për të cilat është 300,000.00€.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Evidentimi i punëtorëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës dhe në ndërmarrjet e tjera publike.</p>	<p>Është bërë evidentimi i punëtorëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës, përfshirë edhe Ndërmarrjet Publike Lokale.</p>	<p>I përmbushur</p>

<p>Krijimi i një këshillimore paramartesore si pjesë e përgjegjësive dhe e programit parandalues për numrin e madh të rasteve të dhunës në familje, shkurorëzimit, dhe lënies së fëmijëve pa përkujdesje familjare.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Themelimi i linjës së telekëshillimit e cila do të ndihmojë viktimat e dhunës në familje të zhvillojnë terapi këshillimi në platforma elektronike.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Zhvillimi i strehimit familjar dhe trajtimi i familjeve strehuese nga aspekti financiar</p>	<p>Drejtorja për Mirëqenie Sociale nëpërmjet mbështetjeve financiare ofron shërbim në trajtimin e familjeve strehuese duke i subvencionuar së paku një herë në vit.</p>	<p>I përmbushur</p>
<p>Zhvillimi i planit trevjeçar të banimit social dhe sigurimi i banimit social të përkohshëm apo të përhershëm për familjet nënevojë sociale për strehim, me theks të veçantë të nënave vet ushqyese dhe të viktimave të dhunës në familje.</p>	<p>Banimit social do të rregullohet përmes rigjenerimit urban si dhe rregulloreve tjera që lidhen me planifikim e cila parasheh që brenda blloqeve të banimit do të ketë numër të caktuar të njësive banesore për kategoritë sociale.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Funksionalizimi i qendrës për fëmijët me Sindromin Down.</p>	<p>Është kompletuar në tërësi ndërtimi i objektit dhe inventarizimi i qendrës. Aktualisht është në fazën e ndërtimit të trafos për furnizim me energji elektrike dhe do të jetë e gatshme për shfrytëzim nga fillimi i vitit 2023.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Ndërtimi i shtëpive për mbrojtje dhe strehim të fëmijëve të lënë pas dore, të keqtrajtuar, dhe pa përkujdesje familjare.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ofrimi i trajtimit profesional të fëmijëve në situatë rruge, fëmijëve në punë të rënda dhe të rrezikshme.</p>	<p>Komuna e Prishtinës përballet me qindra lëmshë-kërkues. Të njëjtit trajtohen nga DMS, QPS dhe partnerët joqeveritarë. Tashmë kemi realizuar 3 fushata ndërgjegjësuese për parandalimin e këtyre dukurive. Kemi thelluar bashkëpunimin me Qendrën për Qëndrimin Ditor për fëmijët në situatë rruge dhe gjithashtu fëmijët e evidentuar (vazhdueshëm) trajtohen nëpërmjet TMR (Tryeza për Menaxhimin e rasteve) nga QPS – si i vetmi institucion profesional i mandatuar për të ofruar këtë trajtim.</p>	<p>I përmbushur/vazhdon çdo ditë</p>
<p>Ndërtimi i shtëpive të reja në lagje për të moshuar me qëndrim ditor.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ndërtimi i shtëpisë me bazë në komunitet për persona me çrregullime mendore</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ngritja e qendrave rehabilituese për përdorues të substancave narkotike.</p>		<p>Nuk ka filluar</p>

Përkrahje ndaj strehimorese se komunitetit LGBT dhe të sigurohemi që të ndajmë buxhet të mjaftueshm për këtë strehimore.		Nuk ka filluar
Rehabilitimi i personave të pastrehë dhe lypsarët, duke u ofruar atyre mundësi për të siguruar jetësën përmes formave të tjera.		Nuk ka filluar
Lirimi nga pagesa e shfrytëzimit të transportit publik për nxënësit, pensionistët, dhe shtresa sociale të ndryshme.	Për pensionistë dhe rastët sociale linjat e transportit publik janë falas, por jo edhe linjat që mbuloohen nga operatorët privat. Ndërsa për nxënës dhe studentë ka zbritje, por jo lirim nga pagesa.	I përmbushur
Renovimi i objekteve sportive ekzistuese.	Ka filluar renovimi i fushës së sportit (basketbollit, futbollit) dhe të fushat e tenisit – të Pishina e Gërmisë. Është në fazën e tenderimit kontrata për renovimin e hapësirave tjera sportive nëpër lagje dhe fshatra (€82 000) e cila pritet të nënshkruhet gjatë muajit Dhjetor (nëse nuk ka pengesa ligjore).	Pjesërisht e përmbushur
Ndërtimi i sallave të edukatës fizike në gjitha shkollat ku ka me shumë se 100 nxënës		Nuk ka filluar
Organizimi i garave shkollore në disa lloje të sporteve.	Buxheti për këtë aktivitet është ndarë për vitin 2023. Është krijuar draft-kalendari i garave. Implementimi i garave shkollore planifikohet të fillojë në Shtator 2023 (me fillimin e ri të vitit shkollor 2023)	I filluar
Nxënësit do të mund të mësojnë notin në klasën e shtatë, duke shfrytëzuar pishinat private.		Nuk ka filluar
Ndërtimi i Qendrës Nacionale për Sport dhe Stadiumit Kombëtar në Bërnice të Poshtme.	Janë alokuar €1,3 mil në Drejtorinë e Sportit për Zhvillimin e Qendrës Nacionale të Sportit. Ështëpërmbyllur faza e parë e prokurimit sipas modelit design and build dhe jemi në proces të vlerësimit për fazën e parë. Ky proces është duke u zhvilluar nën mbështetjen e ekspertëve të USAID-it.	I filluar
Ndërtimi i Pishinës Olimpikë të Notit	Kanë përfunduar analizat ku në bazë të analizave profesionale është paraparë të bëhet tek Kampusi Sportiv bashkë edhe me Sallën e Lojërave me Dorë. Projekti I paraparë për të Pishina e Gërmisë, është në modifikim e sipër për rrethanat e reja,	I filluar
Rritja e kapacitetit të tribunës lindore të stadiumit “Fadil Vokrri” për 8,000 ulëse shtesë		Nuk ka filluar

<p>Ndërtimi i zveshtores dhe tribuna me nga 1,500 deri në 2,000 ulëse në stadiumet e klubeve futbollistike “Flamurtari”, “2 Korriku”, “Rilindja”, “Ramiz Sadiku”, “Kosova e Prishtinës”.</p>	<p>Është duke u punuar në zgjerimin e tribunave dhe rregullimin e fushave të klubeve “2 korriku” dhe “Flamurtari”.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Funksionalizimi i stadiumit periferike të përshtatshme për shkolla të futbollit në Barilevë, Bardhosh, Bërnice, dhe Matiqan.</p>	<p>Projektet janë në Buxhetin e vitit 2023. Është duke u punuar në projektet e detajuar për secilën fushë të cilat planifikohet të tëndërohen në fillim të vitit 2023.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Renovimi i palestrës së madhe në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve dhe ndërtimi i tri palestrave të tjera me kapacitet prej 300 ulëseve, të shfrytëzueshme për sporte individuale dhe kolektive</p>	<p>Është nënshkruar kontrata për tri shkolla të reja ku do të ndërtohen tri palestra sportive.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Ndërtimi i shtigjeve të atletikës.</p>	<p>Ka përfunduar renovimi i shtegut të vrapimit në parkun e Arbërisë, është ndarë buxheti për renovimin e shëgut të atletikës së Taulbahçës.</p>	<p>Pjesërisht i përmbushur.</p>
<p>Rritja e subvencioneve për të gjitha klubet sportive në Komunën e Prishtinës.</p>	<p>Klubet e mëdha sportive janë subvencionuar me rritje përmes thirrjes së veçantë nga Kryetari (krahasuar me vitet paraprake), ndërsa Drejtoria për Sport ka rritur shumën e subvencioneve për vitin 2023 për të gjitha klubet dhe aktivitetet sportive.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Subvencionimi i shkollimit të trajnerëve në sporte të ndryshme pranë federatave përkatëse.</p>	<p>Është bërë subvencionimi i trajnimit për trajner të Basketbollit pranë Federatës së Basketbollit.</p>	<p>Pjesërisht i përmbushur.</p>
<p>Funksionalizimi i skiliftit në Parkun e Gërmisë</p>		<p>Nuk ka filluar</p>
<p>Ndërtimi i fitneseve natyrale në parqe dhe kënde strategjike të Prishtinës, me pajisje që i rezistojnë natyrës.</p>	<p>Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë vendosur pajisje të tilla (fitnes në natyrë) në parkun e Gërmisë dhe në Bregun e Diellit (te banesat e bardha). Është nënshkruar kontrata dhe ka filluar implementimi edhe për tri fitnese tjera.</p>	<p>Gjysëm i përmbushur</p>
<p>Hapja e shtigjeve të reja për ecje dhe biçikleta në Bërnice të Epërme dhe në fshatrat e Gollakut.</p>	<p>Janë të ndara €30 000 për hapjen e shtigjeve të reja. Kemi konsultuar komunitetin e biciklistëve dhe jemi duke e vendosur lokacionin më të favorshëm. Ne process është implementimi i projektit të rrjetimit të shtigjeve në Germi (Shenhezimi dhe Digjitalizimi). Gjithashtu, është hartuar projekti “Definimi dhe krijimi i rrjetit bazik të shtigjeve rekreative në zonat malore të Prishtinës (Gollak). Ky projekt pritet të implementohet gjatë vitit 2023.</p>	<p>I filluar</p>

Ndërtimi i patinazhit të qytetit		Nuk ka filluar
Ndërtimi i këndeve të lodrave për fëmijë në qytet, lagje, dhe fshatra.	Gjatë periudhës janar-dhjetor 2022 janë vendosur kënde të lojërave në lagjen Emshir, Bregun e Diellit dhe fshatrat Bardhosh dhe Hajvali. Poashtu është nënshkruar kontrata edhe për 5 kënde tjera lodrash, ku 2 prej tyre pritet të përfundojnë në fund të dhjetorit 2022. Drejtoria e Menaxhimit të Hapësirave Publike dhe Parqeve në bashkëpunim me YARL dhe OSCE për herë të parë do të vendos dy lodra për fëmijë me aftësi të kufizuar në lagjen Ulpiana, projekt I cili do të shtrihet edhe në lagjet e tjera. Kënde të lodrave dhe fitnesit do të vendosen në Parkun e Ri në Breg të Diellit (rr. “Zekerija Cana), dhe në Kodren e Trimave në mes të rrugëve “Bedri Gjini”, dhe “Carraleva”	Gjysëm i përbushur
Riparimi i fushave futbolistike në “Kodren e Trimave”, tek “Princi i Arbërit”.	Është nënshkruar kontrata dhe në fillim të vitit 2023 fillon implementimi i saj.	I filluar.
Ndërtimi i terrenëve të tenisit në shumë lagje		Nuk ka filluar
Ndërtimi i Parkut për Patinim (Skate Park) për të rinjtë.	Kemi analizuar dhe kemi ardhur në përfundim që Projekti për Skate-Park për shkak të disa ndryshimeve të lokacionit është duke u ri-organizuar dhe do të implementohet te Princi Arberit.	I filluar
Rritja e përkrahjes financiare për ekipet e vajzave në sport dhe për aktivitetet kulturore për gratë dhe vajzat.	Gjatë periudhës janar-qershor 2022 Komuna e Prishtinës ka bërë disa thirrje publike për mbështetje financiare ndaj klubeve, subjekteve dhe shoqatave të ndryshme. Me subvencionë për kulturë, rini dhe sport janë mbështetur më shumë projektet e udhëhequra nga gratë apo që i dedikohen grave. Poashtu komuna ka mbështetur për herë të parë festivalin “vajzat në TIK” që ka të bëjë me promovimin dhe fuqizimin e grave në fushën e programimit dhe teknologjisë.	I përbushur

<p>Kompletimi dhe miratimi i hartës zonale të Prishtinës.</p>	<p>Paralelisht është duke u punuar në draftimin e hartës zonale dhe plotësimin e PZHKs. Janë mbajtur një sërë diskutimesh publike me qëllim të përfshirjes së kërkesave të qytetarëve gjatë planifikimit në mënyrë që ky dokument të jetë më real.</p> <p>Drejtorja e Kadastrit ka siguruar të gjitha të dhënat kadastrale (në formë të shp file) të kërkuara nga Drejtoria e Planifikimit dhe ekspertët që janë duke punuar në përfundimin e HZK, si dhe të dhënat ekzistuese mbi rrjetin e ujësjellësit, kanalizimit – atij fekal dhe atmosferik. I gjithë materiali i mbledhur është digjitalizuar në format GIS duke përfshirë edhe materialet e mbledhura nga ndërrmarjet publike komunale/ regjionale.</p>	<p>I filluar</p>
<p>Kompletimi dhe miratimi i planeve të hollësishme rregulluese.</p>	<p>Është inicuar hartimi i planit të hollësishëm rregullativ për Kalbrinë dhe Arbëria 3. Me anë të PRRHs Kalabria krijohet mundësia e hapjes së rrugës A me anë të shpronësimit përmes kompensimit me të drejtë ndërtimi (tokenizim)</p>	<p>I filluar</p>
<p>Përsheptimi i procesit të legalizimeve të ndërtimeve pa leje në Prishtinë.</p>	<p>Komuna e Prishtinës ka bërë fushatë të gjerë informuese në rrjetet sociale, web faqe dhe në media për kohën e aplikimit dhe menyrën e legalizimit të ndërtimeve pa leje. Drejtoria e urbanizmit, Sektori I Legalizimit gjate periudhjes Janar-Dhjetor 2022, ka legalizuar/leshuar 552 certifikata te legalizimit, dhe ka nxjerrur 528 Vendime per perfshirjen ne liste te pritjes per objekte te cilat nuk kane patur te rregulluar ceshtjet pronesore.</p> <p>Gjithashtu sipas Raportit kredibil të USAID-it që mbështet komunën e Prishtinës në gjashtëmujorin e parë (janar-qershor 2022) Drejtoria e Kadastrit ka pas një përformancë prej 87.00% në realizimin e lëndëve të legalizimit (duke lëshuar 500 vendime).</p>	<p>I filluar</p>